




” Alb Audit ” Sh.P.K.



Ndërmarrja Publike Lokale “Higjiëna” Sh.A.

Deçan

Raporti i Auditorit të Pavarur

Pasqyrat Financiare

31 Dhjetor 2021

Përmbajtja

-Raporti i auditorit të pavarur	3-4
-Pasqyrat financiare.....	5- 9
-Informata të përgjithshme mbi biznesin.....	10
- Adoptimi i standardeve ndërkombetare të raportimit financiar.....	11- 13
-Pasqyrat e politikave kontabël dhe shpalosjet financiare.....	14- 18
-Vlerësimet dhe gjykimet, shtrirja e auditimit dhe përfundimi.....	18- 21

RAPORT I AUDITORIT TË PAVARUR

Menaxhmentit të Shqërisë Aksionare "NPL- Higjiena" Deçan

Opinionit i Auditorit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare shoqëruese të Sh.A. "NPL- Higjiena", që përfshinë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2021, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet dhe pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin që ka përfunduar, si dhe një përmbledhje të politikave të kontabilitetit dhe shënimeve tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare shoqëruese paraqesin një pamje të vërtetë dhe të drejtë, në të gjitha aspektet materiale të pozicioneve financiare të shqërisë aksionare "NPL- Higjiena" më datë 31 dhjetor të vitit 2021. Kjo përfshinë rezultatet e operacioneve të saj, pasqyrës së pozicionit financiar, pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve, pasqyrës së rrjedhës së parasë dhe pasqyrës së ndryshimeve në ekuitet për përdhën e përfunduar përveç çështjeve të përshkruara në pjesën e raportit "Baza për Opinion", në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar(SNRF).

Baza për Opinionin

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA- të).

Përgjegjësia jonë është të japim një mendim mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimit e bërë.

Gjatë angazhimit tonë, ne ishim të pavarur nga shoqëria në përputhje me kodin e etikës për profesionistët kontabël (kodi i BSNEPK), së bashku me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Kosovë. Po ashtu ne kemi përmbushur përgjegjësitë tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me kodin e BSNEPK. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Megjithatë konsiderojmë se është e nevojshme dhe e domosdoshme të theksojmë çështje në vijim si përkujtim menaxhmentit për veprim të nevojshëm për kompani dhe atë:

Në regjistrat e klientëve prezantohet dhe shifet gjendja e përshkruar e klienteve, po ashtu në prezantimin e pasqyrave financiare të vitit 2021 shifet gjendja e llogarive të arkëtueshme dhe atë:

	2020	2021
- Gjendja llogarive te arketueshme	143,888.00	205,727.00
Gjithsej.....	143,888.00	205,727.00

Rritja e gjendjes se llogarive te arketueshme nga viti 2020 ne vitn 2021 prej 42.98% duhet te jetë një sinjal për menaxhmentin e kompanisë që qështjes së llogarive të arkëtueshme ti kushtohet kujdes i shtuar si ne aspektin e angazhimit professional po ashtu edhe atij material. Rekomandojmë që llogaritë e arkëtueshme të jenë pozicioni kontabël i cili padyshim të trajtohet me prioritet, duke rishikuar dhe pastruar këto llogari në periudha sa më të shkurtra.

Çështjet Kryesore të Auditimit

Auditimi përfshinë ekzaminimin në bazë të testeve të dhënave në mbështetje të shifrave dhe shpalosjeve në pasqyrat financiare. Gjatë bërjes së këtyre vlerësimeve të rrezikut, auditori konsideron të përshtatshëm kontrollin e brendshëm për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare të kompanisë në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të duhura në rrethana, por jo për qëllim të shprehjes së një mendimi në efektivitetin e kontrollit të brendshëm të kompanisë. Auditimi gjithashtu përfshinë vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, dhe arsyeshmërinë e politikave të përdorura si dhe nevojën e vlerësimeve kontabël të bëra nga

menaxhmenti, gjithashtu edhe prezantimin e përgjithshëm të pasqyrave financiare. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësia e drejtimit dhe personave të ngarkuar me qeverisjen në lidhje me pasqyrat financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në pajtueshmëri me SNRF- të, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të gabimit apo mashtrimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësitë e shoqërisë (kompanisë) për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë, përveç se kur drejtimi synon ta likujdoj biznesin ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternative tjetër reale përveç sa më sipër. Të ngarkuarit me qeverisjen e kompanisë janë përgjegjës për mbikqyrjen e procesit të raportimit financiar të biznesit.

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare që japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.


Përgjegjësia e audituesit të pavarur

Objektivat tona gjatë auditimit janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që perfshinë opinion tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikoj gjithmonë një anomali materiale kur ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose se bashku, pritet në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

" Alb Audit " Sh.P.K.
Renzi Jashari, Auditor Ligjor

rr. Fehmi Lladrovi nr.2, Ferizaj



Prill, 2022

01.01.2021-31.12.2021

Emri i kompanisë: **HIGJIËNA SH.A.** NPL HIGJIËNA Sh.a
 Numri Unik Identifikues: 811299082
 Adresa: Rr. Bëshket e Deçanit, pn, Deçan


Pasqyra e pozitës financiare më 31 dhjetor 2021

	Shënimi	2021	2020
PASURITË			
Pasuritë afatshkurtra			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	3.3	9,467	30,182
Investimet financiare afatshkurtra		-	
Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	3.4	205,727	143,888
Stoqet	3.5	-	-
Pasuritë e tjera afatshkurtra	3.4.1	824	8,885
Gjithsej pasuritë afatshkurtra		216,018	182,955
Pasuritë afatgjata			
Investimet në pjesëmarrje		-	-
Pasuritë Biologjike	3.2	11,325	-
Investimet financiare afatgjata		-	-
Prona, pajisjet dhe impiantet	3.2	152,396	82,863
Prona investuese		-	-
Investimet në vijim		-	-
Pasuritë e paprekshme		-	-
Pasuritë e shtyra tatimore		-	-
Pasuritë e tjera afatgjata		-	-
Gjithsej pasuritë afatgjata		163,721	82,863
Gjithsej pasuritë		379,740	265,819
DETYRIMET DHE EKUITETI			
DETYRIMET			
Detyrimet afatshkurtra			
Mbitërheqja bankare		-	-
Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	3.8	34,450	904
Kreditë dhe huatë, pjesa afatshkurtër		-	-
Interesi i pagueshëm		-	-
Tatimin në fitim i pagueshëm		-	-
Provizionet afatshkurtra		-	-
Detyrimet ndaj lizingut financiar, pjesa afatshkurtër		-	-
Detyrimet e tjera afatshkurtra	3.7	18,384	3,838
Gjithsej detyrimet afatshkurtra		16,065	4,741
Detyrimet afatgjata			
Kreditë dhe huatë, pjesa afatgjatë	3.7	-	-
Provizionet afatgjata		-	-
Detyrimet ndaj lizingut financiar, pjesa afatgjatë		-	-
Detyrimet e shtyra tatimore		-	-
Detyrimet e tjera afatgjata	3.7	308,605	252,364
Gjithsej detyrimet afatgjata		308,605	252,364
Gjithsej detyrimet		324,671	257,105
EKUITETI			


01.01.2021-31.12.2021

Fitimet (Humbjet) e mbajtura	3.13	52,126	5,771
Rezervat e tjera		-	-
Gjithsej ekuiteti		55,069	8,714
Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet		379,740	265,819


U.D./ Kryoshefit Ekzekutiv


 Kusnetin Lajçati

Kontabilist I, certifikuar


 Denis Hoxha


Zyrtari Kryesor Financiar


 ALBANE HAJDINI


01.01.2021-31.12.2021

Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse
për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2021

	Shënimi	2021	2020
Të hyrat	3.6	517,671	456,137
Kostoja e shitjes	3.9	-	-
Fitimi / (humbja) bruto		517,671	456,137
Të ardhurat tjera	3.6	35,064	19,406
Shpenzimet e shpërndarjes	3.10.2	137,961	165,233
Shpenzimet administrative	3.10.1	376,132	302,071
Shpenzimet e tjera		-	-
Fitimi / (humbja) operativ		38,643	8,239
Shpenzimet financiare	3.10.3	-	-
Të ardhurat financiare	3.6	7,712	-
Fitimi / (humbja) para tatimit		46,355	8,239
Shpenzimet e tatimit në fitim		-	-
Fitimi / (humbja) i/e vitit		46,355	8,239
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse:			
Diferencat këmbimore nga përkthimi i pasqyrave financiare të operacioneve të huaja, neto nga tatimi		-	-
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse të vitit:			
Gjithsej të ardhurat/(humbjet) gjithëpërfshirëse të vitit		46,355	8,239

Kryeshjefti Ekzekutiv

[Signature]
KUSHTETIMI I QENËT
Kontablist i certifikuar
[Signature]
BOJCE BETAHAJ



Zyrtari Kryesor Financiar

[Signature]
ALBANE ARDITAJ

01.01.2021-31.12.2021

Pasqyra e rrjedhjes së parasë
për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2021


	Shënimi	2021	2020
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative			
Fitimi / (humbja) para tatimit		46,355	8,239
Rregullimet për zërat jo në para të shpenzimeve dhe të hyrave			
Zhvlerësimi i pronës, pajisjeve dhe impianteve	3.2	21,450	49,739
Dëmtimi i pronës, pajisjeve dhe impianteve		-	-
Amortizimi i pasurive të paprekshme		-	-
Humbjet nga dëmtimi në pasuritë e paprekshme		-	-
Ndryshimi i vlerës së pronës investuese		-	-
Të ardhurat financiare	3.6	7,712	-
Shpenzimet financiare	3.10.1	-	-
(Fitimi) / humbja nga shitja e pronës, fabrikës dhe pajisjeve	3.12	-	-
Shpenzimet e tatimit në fitim		-	-
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative		75,517	-
Ndryshimet në pasuritë dhe detyrimet operative			
(Rritja) / zvogëlim në llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	3.4	-61838.94	-
(Rritja) / zvogëlimi në stocje	3.5	-	-
(Rritja) / zvogëlimi në pasuritë e tjera	3.4.1	8,061	-
Rritja / (zvogëlimi) në llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	3.8	33,546	-
Rritja / (zvogëlimi) në detyrimet e tjera	3.7	14,547	-
Tatimi në fitim i paguar		-	-
Interesi i paguar	3.10.3	-	-
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet operative		69,832	-
Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese			
Pagesat për blerjet e pronës, pajisjeve dhe impianteve	3.2	- 102,182	-
Arkëtimet për shitjet e pronës, pajisjeve dhe impianteve	3.12	-	-
Pagesat për blerjet e pasurive të paprekshme		-	-
Arkëtimet për shitjen e pasurive të paprekshme	-	56,241	-
Interesi i arkëtuar		-	-
Dividendat e arkëtuara		-	-
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet investuese	-	158,423	-
Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese			
Deponimet e kapitalit shtesë	3.13	21,521	-
Dividendat e paguara		-	-
Arkëtimet nga kreditë dhe huatë	3.7	-	-
Ripagimi i kredive dhe huave	3.7	-	-
Arkëtimet dhe Pagesat tjera investuese		46,355	-
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet financuese		67,876	-
Rritja/(zvogëlimi) neto i parasë dhe ekuivalentëve të parasë	-	20,715	-
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të vitit	3.3	30,182	-
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të vitit		9,467	30,182

U.D I. Kryeshefit Ekzekutiv

[Signature]
Kontabilist i certifikuar

Kontabilist i certifikuar

[Signature]
Percy B. Hysaj



Zyrtari Kryesor Financiar

[Signature]
Arbana / Ardit

01.01.2021-31.12.2021

Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet
për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2021


	Kapitali aksionar	Fitimet e mbajtura	Rezervat tjera	Gjithsej
Gjendja më 1 janar 2020	2,943	2,468	-	475
Fitimi / (humbja) i/e vitit	-	8,239	-	8,239
Korigjimet e Fitimit të mbajtur	-	-	-	-
Dividendat	-	-	-	-
Deponimet / (Terheqjet) e kapitalit shtesë	-	-	-	-
Ndarja e rezervave	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2020	2,943	5,771	-	8,714
Gjendja më 1 janar 2021	2,943	5,771	-	8,714
Fitimi / (humbja) i/e vitit	-	46,355	-	46,355
Korigjimet e Fitimit të mbajtur	-	-	-	-
Dividendat	-	-	-	-
Deponimet / (Terheqjet) e kapitalit shtesë	-	-	-	-
Ndarja e rezervave	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2021	2,943	52,126	-	55,069

U.D I Kryeshefit Ekzekutiv

[Signature]
KRYESHEFIT EKZEKUTIV

Kontabilist i certifikuar

[Signature]
KONTABILISTI I CERTIFIKUAR



Zyrtari Kryesor Financiar

[Signature]
ZYRTARI KRYESOR FINANCIAR

1. TË DHËNAT E PËRGJITHSHME

Ndërmarrja Publike Lokale "Higjiena" Sh.A. është shoqëri aksionare me aktivitete te pershkruara me poshte. Kompania është e regjistruar në Zyrën e Regjistrimit të Ndërmarrjeve Biznesore dhe Emrave Tregëtar në Kosovë bazuar ne ligjin 2007/05-L-123 mbi shoqëritë tregëtare dhe posedon nr. unik identifikues 811299082. Biznesi po ashtu, posedon çertifikatë regjistrimi për T.V.Sh. nr. 330427155. Biznesi është i regjistruar si Ndërmarrje Sherbyese dhe aktivitet kryesor ka grumbullimin e mbeturinave jo të rrezikshme me shifër veprimtarie 3811.

Themelues dhe aksionrë të biznesit është Komuna Deçanit.

Kompania ka fushëveprimin të përcaktuar në çertifikatën e regjistrimit të biznesit, ndërmarrje shërbyese me aktivitet kryesor të cekur më lartë. Ndërmarrja është regjistruar edhe për kryerjen e aktiviteteve sekondare dhe aktiviteteve tjera sic pershkruhet me poshte:

Perfaqësues i autorizuar

Emri	Mbiemri	Pozita në biznes	Autorizimet
Kushtrim	Loshaj	Drejtor menaxhues	Sipas ligjit dhe statutit.

Pronar/ Aksionarë

Emri Mbiemri	Kapitali në €	Kapitali në %
Komuna Deçan	10,000.00€	100.00%

Njësitë

Nr	Numri i njësesë	Emri	Vendi
----	-----------------	------	-------

Aktivitetet/et

Kodi	Përshkrimi	Tipi
3811	Grumbullimi i mbeturinave jo të rrezikshme	Primarë
3821	Trajtimi dhe asgjësimi i mbeturinave jo të rrezikshme	Sekondarë
4312	Përgatitja e vendpunishtes	Tjera
3812	Grumbullimi i mbeturinave të rrezikshme	Tjera
8121	Pastrimi i përgjithshëm i ndërtesave	Tjera
8122	Aktivitetet e tjera të pastrimit të ndërtesave, objeteve industriale	Tjera
8129	Aktivitetet e tjera të pastrimit	Tjera
9311	Funksionimi i objekteve sportive	Tjera
9312	Aktivitetet e klubeve sportive	Tjera
9319	Aktivitetet e tjera sportive	Tjera
9329	Aktivitetet e tjera të argëtimit dhe rekreacionit	Tjera
3700	Kanalizimi	Tjera

Adoptimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar të reja dhe të rishikuara - Standardet dhe interpretimet në fuqi në periudhën aktuale

Standardet e mëposhtme, ndryshimet në standardet ekzistuese dhe interpretimet të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit janë efektive për periudhën e tanishme:

- **SNK 8 - Politikat e Kontabilitetit, Ndryshimet në Vlerësimet e Kontabilitetit dhe Gabimet** - SNK 8 "Politikat e Kontabilitetit, Ndryshimet në Vlerësimet e Kontabilitetit dhe Gabimet" është aplikuar në zgjedhjen dhe zbatimin e politikave të kontabilitetit, kontabilizimin e ndryshimeve në vlerësime dhe pasqyrimin e korigjimeve të gabimeve të periudhës së mëparshme. Standardi kërkon pajtueshmëri me çdo SNRF specifike që zbatohet për një transaksion, ngjarje ose kusht dhe ofron udhëzime për zhvillimin e politikave të kontabilitetit për zërat e tjerë që rezultojnë në informacione të rëndësishme dhe të besueshme. Ndryshimet në politikat e kontabilitetit dhe korigjimet e gabimeve zakonisht llogariten në mënyrë retrospektive, ndërsa ndryshimet në vlerësimet e kontabilitetit zakonisht llogariten në bazë të perspektivës. (Ndryshimi është efektiv për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas 1 janarit 2020. Lejohet aplikimi i më hershëm.)
- **SNK 39 - Instrumentet Financiare: Njohja dhe Matja** - SNK 39 "Instrumentet Financiare: Njohja dhe Matja" përshkruan kërkesat për njohjen dhe matjen e aktiveve financiare, pasiveve financiare dhe disa kontratave për të blerë ose shitur artikuj jo-financiarë. Instrumentet financiare njihen fillimisht kur një njësi ekonomike bëhet palë në provizionet kontraktuale të këtij instrumenti dhe klasifikohen në kategori të ndryshme në varësi të llojit të instrumentit, i cili më pas përcakton matjen pasuese të instrumentit (zakonisht kostoja e amortizuar ose vlera e drejtë). Rregulla të veçanta zbatohen për derivativët e përfshirë dhe instrumente mbrojtëse. (Në fuqi nga 1 janari 2011, lejohet aplikimi i më hershëm. Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2020.)
- **SNRF 4 - Kontratat e Sigurimit [zëvendësohen]** - SNRF 4 "Kontrata e Sigurimit" zbatohet, me përjashtime të kufizuara, për të gjitha kontratat e sigurimit (përfshirë kontratat e risigurimit) që një njësi ekonomike lëshon dhe për kontratat e risigurimit që ajo mban. Në dritën e projektit gjithëpërfshirës të IASB mbi kontratat e sigurimit, standardi siguron një përjashtim të përkohshëm nga kërkesat e disa SNRF-ve të tjera, përfshirë kërkesën për të marrë parasysh SNK 8 "Politikat e Kontabilitetit, Ndryshimet në Vlerësimet e Kontabilitetit dhe Gabimet" kur zgjedhin politikat e kontabilitetit për kontratat e sigurimit. (Në fuqi nga 1 janari 2011, lejohet aplikimi më i hershëm. Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2020. Lejohet aplikimi i më hershëm.)
- **SNRF 7 - Instrumentet Financiare: Shpalosjet** - SNRF 7 "Instrumentet Financiare: Dhënia e informacioneve shpjeguese" kërkon dhënien e informacionit në lidhje me rëndësinë e instrumenteve financiare të një njësie ekonomike, natyrën dhe shtrirjen e risqeve që vijnë nga instrumentat financiarë, si në aspektin cilësor dhe sasior. Kërkohen shpalosje specifike në lidhje me aktivet financiare të transferuara dhe një numër çështjesh të tjera. (Në fuqi nga 1 janari 2011, lejohet aplikimi më i hershëm. Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2020. Lejohet aplikimi i më hershëm.)
- **SNRF 9 - Instrumentet Financiarë** - Versioni përfundimtar i SNRF 9 "Instrumentet Financiare" të lëshuar në Korrik 2014 është zëvendësimi i IASB i SNK 39 "Instrumentet Financiare: Njohja dhe Matja". Standardi përfshin kërkesat për njohjen dhe matjen, zhvlerësimin, çregjistrimin dhe kontabilitetin e përgjithshëm mbrojtës. (Në fuqi nga 1 janari

2011, lejohet aplikimi i më hershëm. Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2020. Lejohet aplikimi i më hershëm.)

- **SNRF 16 – Qiratë** - SNRF 16 specifikon mënyrën e njohjes, matjes, paraqitjes dhe zbulimit të qirave. Standardi siguron një model të vetëm të kontabilitetit të qiramarrësit, që kërkon njohjen e aktiveve dhe pasiveve për të gjitha qiratë, përveç nëse afati i qirasë është 12 muaj ose më pak ose aktivi bazë ka një vlerë të ulët. Kontabiliteti i qiradhënësit gjithsesi mbetet kryesisht i pandryshuar nga SNK 17 dhe ruhet dallimi midis qirave operative dhe financiare. (Në fuqi nga 1 janari 2019, lejohet aplikimi i më hershëm. Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2020. Lejohet aplikimi i më hershëm.)
- **SNK 1 - Prezantimi e Pasqyrave Financiare** - SKN1 përcakton kërkesat e përgjithshme për prezantimin e pasqyrave financiare duke përfshirë: si duhet të strukturohen, kërkesat minimale për përmbajtjen si dhe konceptet themelore si vijimësia, kontabiliteti në baza akruale dhe dallimet në mes të pasurive/detyrimeve afatshkurta dhe afatgjata.
- Standardi kërkon që një seri e plotë e pasqyrave financiare të përmbajë një pasqyrë të pozicionit financiar, një pasqyrë të fitimit ose humbjes dhe të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse, një pasqyrë të ndryshimeve në kapital dhe një pasqyrë të flukseve të parave. (Në fuqi nga 1 janari 2011, lejohet aplikimi më i hershëm. Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2023. Lejohet aplikimi më i hershëm.)
- **SNK 16 - Aktivët afatgjata materiale** - SNK 16 "Pronë, bimë dhe pajisje" përshkruan trajtimin kontabël për shumicën e llojeve të aktiveve afatgjata materiale. Prona, impiantet dhe pajisjet fillimisht maten me koston e tyre, më pas maten ose duke përdorur një model të koston ose rivlerësimit, dhe amortizohen në mënyrë që shumën e saj e amortizueshme të alokohet në një bazë sistematike gjatë jetës së saj të dobishme. (Efektive për pasqyrat financiare të ndërmjetme dhe vjetore në lidhje me vitet fiskale që fillojnë më ose pas 1 janarit 2011, aplikimi i mëparshëm është i lejuar. Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2022. Zbatimi i hershëm është i lejuar.)
- **SNK 37 - Provizionet, Pasivet dhe Aktivët e Kushtëzuara** - SNK 37 "Provizionet, Pasivet dhe Aktivët e Kushtëzuara" përshkruan kontabilizimin e dispozitave së bashku me aktivët e kushtëzuara (asetet e mundshme) dhe detyrimeve kontigjente (obligimet e mundshme dhe detyrimet aktuale që nuk janë të mundshme ose nuk maten me besueshmëri). (Efektive për pasqyrat financiare të ndërmjetme dhe vjetore në lidhje me vitet fiskale që fillojnë më ose pas 1 janarit 2011, aplikimi i mëparshëm është i lejuar. Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2022. Zbatimi i hershëm është i lejuar.)
- **SNRF 1 - Miratimi për herë të parë i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar** - SNRF 1 "Miratimi për herë të parë i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar" përcakton procedurat që një njësi ekonomike duhet të ndjekë kur miraton SNRF-të për herë të parë si bazë për përgatitjen e pasqyrave të saj financiare të qëllimit të përgjithshëm. SNRF-të jep përjashtime të kufizuara nga kërkesa e përgjithshme për të qenë në përputhje me secilin SNRF efektive në fund të periudhës së tij të parë të raportimit të SNRF-ve. (Efektive për pasqyrat financiare të ndërmjetme dhe vjetore në lidhje me vitet fiskale që fillojnë më ose pas 1 janarit 2011, aplikimi i mëparshëm është i lejuar. Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2022. Zbatimi i hershëm është i lejuar.)
- **SNRF 3 - Kombinimet e Biznesit** - SNRF 3 "Kombinimet e Biznesit" përshkruan kontabilitetin kur një blerës merr kontrollin e një biznesi (p.sh. një blerje ose bashkim). Kombinime të tilla biznesi llogariten duke përdorur 'metodën e blerjes', e cila zakonisht kërkon aktive të blera dhe pasivet e supozuara të maten me vlerat e tyre të drejta në datën e blerjes.

(Efektive për pasqyrat financiare të ndërmjetme dhe vjetore në lidhje me vitet fiskale që fillojnë me ose pas 1 janarit 2011, aplikimi i mëparshëm është i lejuar. Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2022. Zbatimi i hershëm lejohet nëse një njësi ekonomike zbaton gjithashtu të gjitha referencat e tjera të azhurnuara (botuar së bashku me Kornizën Konceptuale të azhurnuar) në të njëjtën kohë ose më herët.)

- **SNRF 17 - Kontratat e Sigurimit** - SNRF 17 përcakton parimet për njohjen, matjen, prezantimin dhe zbulimin e kontratave të sigurimit brenda fushës së standardit. Objektivi i SNRF 17 është të sigurojë që një njësi ekonomike ofron informacione përkatëse që përfaqësojnë me besnikëri ato kontrata. Ky informacion jep një bazë për përdoruesit e pasqyrave financiare për të vlerësuar efektin që kanë kontratat e sigurimit në pozicionin financiar të njësisë ekonomike, performancën financiare dhe flukset e parave. (IASB vendosi me kusht që të shtyjë datën efektive të SNRF 17, Kontratat e Sigurimit në periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2022. [IASB ka publikuar gjithashtu 'Zgjatjen e Përfundimit të Përkohshëm nga Zbatimi i SNRF 9 (Ndryshimet në SNRF 4)' për të shtyrë datën fikse të skadimit të ndryshimit edhe për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2023.]

Biznesi parashikon që adoptimi i këtyre standardeve, rishikimeve dhe interpretimeve nuk do të ketë ndikim material në pasqyrat financiare të subjektit në periudhën e zbatimit fillestar.

2.PASQYRA E POLITIKAVE TË RENDËSISHME TË KONTABILITETIT

2.1.Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgaditur në pajtueshmëri me ligjet dhe udhëzuesit dhe rregullat për zbatimin e tyre, të cilat janë të aprovuara nga organet relevante, si dhe rregullat e standardet tjera të aplikueshme në Kosovë.

2.2.Bazat e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë të paraqitura në valutën Euro. dhe janë të përgatitura në pajtueshmëri me rregullën e kostos historike, por njëkohësisht e modifikuar për paraqitjen e pronës, impianteve dhe paisjeve në shumat e tyre. Politikat e kontabilitetit janë aplikuar në mënyrë konsistente, dhe nëse nuk ceket ndryshe, janë konsistente me ato që janë miratuar në vitin e kaluar financiar.

Përgaditja e pasqyrave financiare konform rregullave kërkon përdorimin e parashikimeve të shpeshta kritike të kontabilitetit. Githashtu këkohet nga menaxhmenti ushtrimi i gjykimit profesional në proceset e aplikimit të politikave kontabël. Periudha raportuese e biznesit përfshinë një periudhë dymbëdhjetë mujore duke përfunduar me 31 Dhjetor të vitit.

2.3.Prona, impiantet dhe paisjet

Vlera e pronës , impianteve dhe paisjeve të N.P.L. "Higjiena" Sh.A. me 01.01.2021 janë bartur sipas kostos minus zhvlersimi i aukumuluar. Kosto paraqet shpenzimin që i atribuohet direkt blerjes si dhe kostot e mirëmbajtjes kapitale. Një zë nga pajisjet dhe makineritë largohet nga bilanci i gjendjes kur shitet ose kur tërhiqet nga përdorimi dhe kur nuk pritet ndonjë benefit i ardhshëm nga ato.

Riparimet dhe mirëmbajtja operuese ngarkohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve atëherë kur ndodhin shpenzimet. Ngarkimi vjetor për amortizimin llogaritet duke përdorur metodën lineare për të gjitha kategoritë e pronës, toka nuk zhvlerësohet.

Shpenzimet pasuese janë përfshirë në vlerën bartëse të asetit apo janë njohur si asete të ndara, në mënyrën e duhur, vetëm atëherë kur përfitimi ekonomik i mundshëm lidhur me to mund të rrjedhë në kompani dhe vlera e mjetit mund të matet seriozisht. Shkalla e zhvlerësimit të aseteve, ne harmoni me jetën e përdorimit nuk dallon nga shkalla e zhvlerësimit sipas ligjeve dhe rregullave në fuqi:

Ndëtesat.....	20 vite
Impiante dhe makineri.....	5 vite
Automjetet dhe paisjet e zyrës.....	5 vite

2.4. Zhvlerësimi i aseteve

Prona, impiantet dhe pajisjet rishikohen për dëmtim kurdo që ndonjë ngjarje ose ndryshimet në bazë të rrethanave tregojnë se shumta bartëse e një aseti nuk mund të rikuperohet. Kurdo që vlera bartëse e një aseti e tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme, një humbje nga rënia në vlerë njihet në të ardhura. Vlera e rikuperueshme e një aseti është çmimi më i lartë shitës neto i një aseti dhe vlera në përdorim. Çmimi neto i shitjes është shumta e arritshme nga shitja e një aseti në një transaksion të vullnetit të lirë, përderisa vlera në përdorim është vlera aktuale e paraparë për të ardhmen e flukseve të parasë që pritet të arrijnë nga përdorimi i vazhdueshëm të një aseti dhe nga heqja e tij në fund të jetëgjatësisë së përdorimit të tij. Vlerat e rikuperueshme llogariten për asetet individuale ose, nëse nuk është e mundur, për njësitë që gjenerojë të ardhura.

2.5.Asetet e paprekshme

Asetet e paprekshme përbëhen nga shtuarit e licencuar për kompjuter. Këto fillimisht deklarohen sipas kostos së tyre dhe më pas sipas kostonus minus amortizimi i akumuluar dhe humbjet e akumuluarat të dëmtimeve, nëse ka pasur. Amortizimi regjistrohet kur këto asete janë në dispozicion për përdorim duke përdorur metodën lineare përderisa kostonat e një aseti të paprekshëm shlyhet përgjat kohëzgjatjes së vlerësuar të përdorimit.

2.6.Instrumentet financiare

Asetet financiare dhe detyrimet financiare njihen kur kompania bëhet pjesë e dispozitave kontraktuese të instrumentit financiar. Asetet financiare nuk njihen kur të drejtat e kontraktuara mbi rrjedhën e parasë nga aseti financiar skadon, ose kur aseti financiar dhe të gjitha rreziqet e konsiderueshme dhe shpërblimet janë transferuar. Detyrim financiar nuk njihet kur ai është shuar, shlyer, anuluar apo skaduar.

Asetet financiare dhe detyrimet financiare janë matur fillimisht me vlerën e drejtë, plus kostonat e transaksioneve, me përjashtim të aseteve dhe detyrimeve financiare të bartura në vlerën e drejtë përmes fitimit apo humbjes, të cilat fillimisht janë matur me vlerën e drejtë. Asetet financiare dhe detyrimet financiare janë matur më pas ashtu si përshkruhet më poshtë.

2.7.Kreditë dhe të arkëtueshmet

Huatë dhe të arkëtueshmet janë pasuri/detyrime financiare me pagesa fikse ose të përcaktuara që nuk janë të kuotuarat në një treg aktiv. Këto përfshihen në pasuri/detyrime qarkulluese, me përjashtim të kredive dhe të arkëtueshmet që kanë maturitet në më shumë se 12 muaj që nga data e bilancit të gjendjes. Kreditë dhe të arkëtueshmet e kompanisë në datën e bilancit të gjendjes përbëhen nga të arkëtueshmet tjera dhe tregtare, paraja dhe ekuivalentët e parasë.

2.8.Stoqet

Stoqet e N.P.L "Higjiena" Sh.A. janë kryesisht rezerva të mallit tregtar si pjesë ndërrimi e materiale hargjuese të lidhura kryesisht me funksionimin e kompanisë. Gjendja e stoqeve është vlerësuar me koston më të ulët dhe vlerën neto të realizueshme, duke përdorur metodën e matjes mesatare dhe përfshinë shpenzimet e kryera në përvetësimin e stoqeve dhe sjelljen e tyre në lokacionin ekzistues dhe gjendjen ekzistuese të tyre.

2.9. Kapitali i Pronarit

Kapitali i Pronarit fillimisht është njohur në gjendjen fillestare të bilancit të gjendjes në mes të vlerës reale të pasurive neto dhe vlerës së kapitalit fillestar të kontribuar nga aksionarët e kompanisë.

2.10.Përfitimet e punëtorëve

Numri i të punësuarve në N.P.L "Higjiena" Sh.A. për periudhën 01.01. deri më 31 dhjetor 2021 ka qenë rreth 48. Në rrjedhat normale të biznesit, entiteti bënë pagesat në emër të punëtorëve të vetë për kontributet pensionale dhe tatimet në të ardhurat personale, të cilat janë të kalkuluarat në bazë të pagave bruto sipas legjislacionit në fuqi. Këto shpenzime i ngarkohen pasqyrës së të ardhurave për periudhën e caktuar kohore.

2.11. Tatimi

Shoqëria Aksionare "Higjiena" N.P.L kërkohej që të paguajë tatim në fitimin e realizuar për çdo periudhë financiare kontabël, bazuar në metodën e të ardhurave reale apo përlllogaritjen e tatimit të realizuar nga periudha e kaluar të rritur me 10% varësisht nga politikat e saj kontabël në përputhshmëri me ligjet e rregulloret në fuqi, për periudhën e caktuar. Biznesi ka paguar tatimin mbi vlerën e shtuar, ka paguar tatimin dhe kontributet në të ardhura personale. Pozicioni i tatimeve të pagueshme në bilancin e gjendjes kërkon zgjidhje pasi që ky është një prej problemeve themelore pas llogarive të arkëtueshme i cili e ngarkon biznesin.

Sipas legjislacionit aktual tatimor, humbjet e tatimit në të ardhura mund të barten për tu vendosur në pesë vitet pas vitit kur ka ndodhur humbja.

2.12. Njohja e të ardhurave

Të ardhurat e kompanisë janë kryesisht mjete të cilat realizohen nga veprimtaria primare e entitetit, faturimi i shërbimeve të pastrimit dhe shërbimeve tjera në baza komerciale, dhe njihen në momentin e faturimit. Të ardhurat njihen kur është e mundur që fitimet ekonomike lidhur me rrjedhën e transakcioneve të kompanisë dhe kur shuma e të ardhurave mund të matet besueshëm, si dhe kur kriteret për secilin nga aktivitetet e ndryshme të kompanisë janë përmbushur. Këto kriteret të njohjes së aktiviteteve specifike janë të bazuara në shërbimet ose zgjidhjet e siguruara ndaj klientit dhe kushteve të kontratës në secilin rast, dhe janë përshkruar më poshtë

Të ardhurat nga koha dhe kontratat materiale njihen sipas metodës së përqindjes së kompletimit. E ardhura njihet përgjithësisht bazuar në çmimin e kontraktuar.

Nëse lind ndonjë rrethanë që mund të ndryshojnë vlerësimin origjinal të ardhurave, kostove ose shkallën e progresit drejt përfundimit, vlerësimet korrigjohen. Këto rishikime mund të rezultojnë në rritje apo zvogëlime në të ardhurat ose shpenzimet e vlerësuara dhe pasqyrohen në të ardhura në periudhën në të cilën rrethanat që shkaktuan inicimin e rishikimit bëhet i njohur nga menaxhmenti.

2.13. Shpenzimet operative

Shpenzimet operative njihen në pasqyrën e të ardhurave në momentin e kryerjes së shërbimit apo në datën e faturimit.

2.14. Provizionet, detyrimet dhe pasuritë kontingjente

Provizionet njihen kur detyrimet e tanishme si rezultat i një ngjarje në të kaluarën, mund të çojnë në një fluks dalës të burimeve ekonomike nga grupi ku shumat mund të vlerësohen në mënyrë të besueshme. Koha apo shuma e daljeve mund të jetë ende e pasigurt. Një detyrim i tanishëm lind nga prania e një zotimi konstruktiv ose detyrimi ligjor që ka rezultuar nga ngjarjet e kaluara. Provizionet nuk njihen për humbjet operative në të ardhmen.

Provizionet maten me shpenzimet e parashikuara të nevojshme për të shlyer obligimin e tanishëm, duke u bazuar në dëshmi të besueshme në dispozicion në datën e raportimit, duke përfshirë rreziqet dhe pasiguritë lidhur me detyrimin e tanishëm. Provizionet zbriten në vlerën e drejtë të tyre, kur vlera kohore e parasë është materiale. Detyrimet kontingjente nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato shpalosen vetëm nëse mundësia e një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Si pasuritë edhe detyrimet kontingjente shpalosen. Shuma e humbjeve kontingjente njihet si

provizion nëse është e mundur që ngjarjet e ardhshme ta konfirmojnë, atë detyrim të shfaqur në bilancin e gjendjes dhe parashikim i arsyeshëm i humbjes që mund të ndodhë.

Një pasuri kontingjente nuk njihet në pasqyrat financiare, por shpaloet kur një fluks hyrës i përfitimeve ekonomike është i mundshëm. Shuma e një humbje kontingjente njihet si provizion nëse ka gjasa që ngjarjet e ardhshme do ta konfirmojnë që, një detyrim ka ndodhur deri në datën e bilancit të gjendjes dhe një vlerësim i arsyeshëm i humbjes së shkaktuar mund të bëhet. Në biznesin NPL "Higjiena" detyrimet kontingjente nuk janë pasqyruar në PF të periudhës 2020&2021-provizionet për borgjet e kqija fare nuk janë pasqyruar. Kjo është vertetuar nga analiza e regjistrave të LL/A nga evidenca kontabel nga sistemi kontabël dhe nga shuma e prezantuar në pasqyra financiare.

3. MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR DHE KAPITAL

Rreziku financiar dhe kapital i biznesit drejtohet nga bordi dhe menaxhmenti ekzekutiv i kompanisë. Objektivat e kompanisë kur menaxhojnë me kapital janë të ruajnë mundësinë që biznesi të vazhdojë me punë në të ardhmen.

3.1.Rreziku kreditor

Mjetet financiare të cilat e vënë kompaninë në rrezik kreditor përbëhen prej parasë në dorë dhe parasë në llogaritë bankare. Paraja dhe ekuivalentët e parasë të kompanisë përbëhen kryesisht nga saldot bankare dhe parave në arka. Ekspozimi maksimal i kompanisë ndaj rrezikut të kredisë është i kufizuar në vlerën bartëse të aseteve financiare të njohura në datën e raportimit.

3.2. Rreziku i likuiditetit

Kompania menaxhon nevojat e saj të likuiditetit duke monitoruar kujdesshëm pagesat e borxheve për detyrimet financiare afatgjate, si dhe hyrjet e parave të parashikuara dhe daljet e parasë nga aktivitetet e përditshme të biznesit. Nevojat për likuiditetin monitorohen në kohë të ndryshme, në bazë ditore dhe javore, si edhe në bazë të një projektimi përsëritës 30 ditësh. Nevojat e likuiditetit afatgjatë për një periudhë identifikohen vazhdimisht. Kërkesa neto e parave krahasohet me mundësitë në dispozicion të huamarrjes në mënyrë që të përcaktoj ndonjë tepriçë apo ndonjë mungesë. Kjo analizë tregon se mundësitë e huamarrjes në dispozicion pritet të jenë të mjaftueshme gjatë periudhës në vërtetim.

Kompania mban para për të përmbushur kërkesat e likuiditetit minimum për periudhën 30-ditore. Financimi i nevojave për likuiditet afatgjatë është një sigurim shtesë nga një shumë e mjaftueshme e mundësisë së burimit të zotuar të mjeteve.

3.3. Politikat dhe procedurat e menaxhimit të kapitalit

Objektivat e kompanisë për menaxhimin e kapitalit janë për të ruajtur aftësinë e biznesit që të vazhdojë aktivitetin mbi parimin e vazhdimësisë në mënyrë që të sigurojë kthime për aksionarët dhe përfitime për palët e tjera dhe për të mbajtur një strukturë optimale të kapitalit për të zvogëluar koston.

3.4. Pasuritë dhe detyrimet

Vlerat bartëse të aseteve dhe detyrimeve financiare të kompanisë të njohura në datën e bilancit të gjendjes të periudhës raportuese nën vështrim gjithashtu mund të kategorizohen. Ekspozimi maksimal i kompanisë ndaj rrezikut të kredisë është i kufizuar në vlerën bartëse të aseteve financiare të njohura në datën e raportimit, të përmbledhura si më poshtë:

Paraja dhe ekuivalentet e parasë

- Paraja në arkë.....	660.69
- Paraja në bankë.....	8,806.27
<u>Gjithsej:.....</u>	<u>9,466.96</u>

Pasuritë qarkulluese dhe kërkesat tjera

- Stokset ne fund të periudhës.....	--
- Llogarite e arkëtueshme tregtare.....	205,727.26
- Parapagimet.....	823.89
<u>Gjithsej:.....</u>	<u>206,551.15</u>

Pasuritë afatgjata materiale

	Trualli	Ndertesa	Automjete- Inventare	Gjithsej
- Kosto				
- 31.12.2021	-	-	249,369.24	249,369.24
- Shtesat	-	-	-	-
- Nxj.jashte perdorimi			-25,783.77	-25,783.77
- Zhvlersimi i akumuluar			-71,189.47	-71,189.47
<u>Vlera neto:</u>	<u>-</u>	<u>-</u>	<u>152,396.00</u>	<u>152,396.00</u>

4.VLERËSIMET DHE GJYKIMET KRITIKE TË KONTABILITETIT

Në zbatimin e politikave të kontabilitetit të kompanisë, të cilat janë përshkruar në Shënimin 2, menaxhmenti kërkohet të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime lidhur me shumën bartëse të aseteve dhe detyrimeve të cilat nuk janë paraqitur nga burime të tjera. Vlerësimet dhe supozimet e lidhura bazohen në eksperiencën historike dhe faktorëve të tjerë që konsiderohen të jenë të rëndësishme për këtë qëllim. Vlerësimet dhe supozimet janë shqyrtuar në një bazë të vazhdueshme. Rishikimi i vlerësimeve të kontabilitetit njihet për periudhën të cilën vlerësimi është bërë, nëse rishikimi ndikon vetëm atë periudhë ose në periudhën e rishikimit, dhe periudhat e ardhshme nëse rishikimi ndikon si në periudhën e tanishme.

4.1. Vlerësimi i pasigurisë

Kurdo që shumën bartëse e një aseti ose një njësi gjeneruese të hollash e tejkalon shumën e rikuperueshme të tij, një humbje nga rënia e vlerës duhet njohur. Kur përcaktohet shumën e rikuperueshme, menaxhmenti vlerëson pritjet e flukseve të parasë nga secila njësi gjeneruese-parash dhe përcakton normën e interesit për llogaritjen e vlerës aktuale të rrjedhjes së parasë.

Menaxhmenti rishikon jetën e dobishme të aseteve të zhvlerësueshme në çdo datë të raportimit. Më 31 Dhjetor 2021, menaxhmenti vlerëson se jeta e dobishme përfaqëson pritjet e përfitimeve nga asetet për kompaninë. Shumat bartëse janë analizuar, megjithatë, mund të ndryshojnë për shkak të vjetërimit teknik. Stokset maten në koston më të ulët dhe vlerën neto të realizueshme. Në vlerësimin e shumave neto të realizueshme, dëshmitë më të besueshme, të dhënat në dispozicion në kohën e bërë merren parasysh.

5. TË ARDHURAT

Shërbimet komunale janë vlera kryesore e shërbimeve të cilat ofron Shoqëria Aksionare "Higjiena" N.P.L gjatë kësaj periudhe ka realizuar shitje dhe ka realizuar të ardhura si më poshtë:

Te ardhurat nga shitjet dhe të ardhura tjera

- Te ardhura nga shërbimet.....	517,671.43
- Te ardhure financiare.....	7,711.86
- Te ardhura tjera(nga grantet).....	35,064.37
<u>Gjithsej:.....</u>	<u>516,447.66</u>

6. KOSTO E SHËRBIMEVE TË OFRUARA

Kosto e shërbimeve të ofruara në kompaninë "Higjiena" N.P.L. gjatë periudhës raportuese 2021 kanë qenë shpenzimet operuese si dhe kostot e personelit të cilat do të prezantojmë më poshtë:

Shpenzimet e personelit

- Paga neto.....	241,108.48
- Kontributet pensionale nga punëdhënësi.....	12,632.37
- Kontributet pensionale nga puntori.....	12,632.37
<u>Gjithsej:.....</u>	<u>266,373.22</u>

Shpenzimet tjera operuese dhe administrative

- Shpenzimet tjera administrative.....	109,758.30
- Shpenzimet e derivateve.....	67,422.52
- Shpenzimet e reklames.....	29,475.17
- Shpenzimet e zhvlersimit.....	21,450.47
- Shpenzimet e magazinimit.....	1,989.87
- Shpenzimet e shitjes.....	17,622.95
<u>Gjithsej:.....</u>	<u>244,719.28</u>

7. ZOTIMET DHE KONTINGJENTET

7.1.Procedimet gjyqësore

Më 31 Dhjetor 2021, kompania nuk ka ndonjë provizion të regjistruar për humbjet potenciale, sa i përket procedimeve gjyqësore. Menaxhmenti i kompanisë, vazhdimisht analizon rrezikun potencial që rezulton nga humbja lidhur me procedime gjyqësore, dhe pretendimet e mundshme kundër kompanisë, që mund të ngritën në të ardhmen. Ndonëse përfundimi i këtyre çështjeve nuk mund gjithmonë të pohohet me precizitet, menaxhmenti i kompanisë beson që nuk ka mundësi të rezultojë ndonjë detyrim material

7.2.Zotimet kapitale

Nuk ka ndonjë zotim kapital domethënës të kontraktuar në datën e bilancit të gjendjes që tani më nuk është njohur në pasqyrat financiare.

8. NGJARJET PASUESE

Pas 31 Dhjetorit 2021 dhe data raportuese deri në miratimin e këtyre raporteve financiare, nuk ka ngjarje të përshtatjes të reflektuar në pasqyrat financiare apo ngjarje që janë materialisht të rëndësishme për shpalosje në këto pasqyra financiare.

9. PËRBUSHJA E PARIMIT TË VIJIMESISË

Nga pasqyrat financiare duke u bazuar në analiza dhe duke bërë teste përmes koeficientëve financiar si dhe rrjedhat tjera si në biznesin i cili është objekt auditimi mund të konstatojmë se biznesi mund të operoj edhe në periudhat e ardhshme duke plotësuar parimin e vijimësisë.

Sipas standardeve të kontabilitetit, ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në lëmin e financave si dhe rregulloret dhe ligjet në lëmin e tatimeve, tregojnë se biznesi është në vazhdimësi të afarizmit dhe kryerjes së obligimeve. Jemi të mendimit se biznesi do të vazhdoj me afarizmin e vet edhe në të ardhmen. Jemi të mendimit në bazë të dhënave nga pasqyrat financiare se detyrimet kompania ka mundësi ti kryej normalisht dhe në vazhdimësi. Këto fakte dhe dëshmi japin mundësi për të vazhduar ekzistencën për një periudhë të arsyeshme kohore me pretendime të qarta për rritje të kapaciteteve operuese dhe kapitalit. Kjo gjithashtu shihet dhe është në përputhje me planet strategjike të kompanisë. Treguesit e rrjedhave fizike dhe financiare për këtë vit japin rezultate të cilat premtojnë. Shihet nga pasqyrat dhe raportet e shitjeve se për vitin 2021 janë realizuar të ardhura standarde me një ngritje krahasuar me vitin paraprak. Nëse bëjmë një analizë përmes koeficienteve financiar, si koeficientet e likuiditetit, efikasitetit dhe rentabilitetit mund të konstatojmë se kompania në këtë periudhë reflekton tregues të volitshëm.

Likuiditeti:

- Koeficienti vijues shënon rezultat inkurajues, ngase pasuritë qarkulluese kalojnë dukshëm detyrimet qarkulluese 15.446 herë në këtë vit. Sipas këtij koeficienti kompania do të duhej të mbulonte çdo euro të detyrimeve qarkulluese me pasuri qarkulluese, të cilin kusht e përmbush.
- Koeficienti i shpejtësisë ku vihen në raport paraja e gatshme dhe llogaritë e arkëtueshme, me detyrimet qarkulluese, ishte poashtu ideal. Ky koeficient është ideal ngase paraja dhe llogaritë e arkëtueshme kalojnë detyrimet qarkulluese disa herë dhe kompania nuk ka pasur nevoj të mendoj që përmes shitjes së detyrueshme të pasurive dhe heqjes dorë nga rezervat, ti paguaj faturat për borxhe nga fakti se detyrimet janë kryer me sukses nga aktivitetet operuese.

Efikasiteti:

- Koeficienti, ditët në llogari të akëtueshme ku vihen në krahasim llogaritë e arkëtueshme me gjithsej shitjet ku del se mesatarja e llogarive të arkëtueshme gjatë vitit 2021 ishte 39,74 ditë. Ndonëse faturimi i shërbimeve bëhet me një afat pagese, ky koeficient nuk ishte i volitshëm. Këta koeficient ndryshe quhen edhe koeficientët e menaxhimit të pasurisë dhe tregojnë se me çfarë efikasiteti kompania menaxhon pasuritë.

Rentabiliteti:

- Koeficienti, diferenca në fitim bruto ku vihet në raport fitimi bruto me shitjet totale nuk jep ndonjë mundësi krahasimi pasiqe kompania nuk i ka ndare kostot direkte.
- Koeficienti, kthimi në kapital ku vihen në krahasim fitimi neto me kapitalin e pronarëve ishte i mirë dhe një shkallë e kthimit prej 84.17 është e volitshme. Këtë koeficient më tepër kompania duhet ta shfrytëzoj për analiza krahasuese me degët tjera.

Bazuar në dëshmitë të cilat mbështesin pasqyrat financiare si dhe procedurat e kryera, jemi të mendimit se mundësitë e plotësimit të parimit të konsistencës mund të arrihen dhe kompania me këtë trend mund të funksionoj edhe një periudhë reale kohore me mundësi të zgjerimit dhe rritjes së mëtutjeshme.

10. FUSHËVEPRIMI, OBJEKTIVAT DHE SHTRIRJA E AUDITIMIT

Auditimi është përformuar në harmoni me ligje e rregulla të aplikueshme. Standardet e përmendura kërkojnë që ne të planifikojmë dhe ekzekutojmë auditimin në mënyrë që të nxjerret një siguri e arsyeshme se gjendjet e prezentuara në pasqyrat financiare nuk kanë pasur keqpohime materiale apo ndryshime. Auditimi jonë përmbanë hulumtimin e informatave të mbledhura të rëndomta për të vërtetuar shumat dhe informatat e prezentuara në raportin financiar. Po ashtu ky raport përmban hulumtimin dhe mendimin mbi politikat e kontabilitetit të cilat janë aplikuar, duke i dhënë rëndësi të veçantë se si janë bërë ato nga menaxhmenti, dhe hulumtimi mbi prezantimin gjeneral të kontove të shoqërisë.

11. SIGURIMI I DËSHMIVE DHE TESTEVE GJATË PROCESIT TË AUDITIMIT

Në N.P.L. "Higjiena" Sh.A. kemi kryer një sërë testesh përmes mostrave të dëshmimeve autentike. Punën e testimit dhe sigurimit të dëshmimeve e kemi zhvilluar me ndihmën e stafit të entitetit ku do të prezantojmë disa prej dëshmimeve dhe mostrave të zgjedhura nga arkivi i librave të kontabilitetit dhe dokumente tjera që janë shfrytëzuar gjatë auditimit.

- Statuti i entitetit
- Procedurat
- Marrëveshja në mes të entitetit dhe të punësuarëve të rregullt dhe kontraktorëve
- Dokumentet e kontabilitetit të cilat janë subjekt i auditimit
- Pasqyrat financiare dhe të aktiviteteve lidhur me entitetin
- Shpalosjet e pasqyrave financiare
- Çdo dokument tjetër i cili ka të bëjë me entitetin

12. NJOHJA DHE VLERËSIMI I KONTROLLIT TË BRENDSHËM DHE SISTEMIT KONTABËL

- Kemi zgjedhur strategjinë e kombinuar, të besimit (me ndihmën dhe asistencën e stafit), dhe të mosbesimit (testeve të pavarura) në kontrollin e brendshëm. Kemi bërë biseda me nivelin e duhur të menaxhmentit, mbikëqyrësve dhe personelit tjetër, inspektimi i dokumentacionit, raporteve dhe dosjeve elektronike. Po ashtu kemi vëzhguar aplikimin e sistemit të kontroleve të brendshme
- Gjatë procedurave audituese, në bazë të asaj që kemi arritur të shohim, mund të konstatojmë se këtu kontrollohen raportet financiare nga disa nivele duke filluar nga kontabilisti, mbikëqyrësit, menaxherët ekzekutiv dhe sipas nevojës dhe materialitetit edhe nga përfaqësuesit e pronarit, respektivisht BD.

13. PËRFUNDIMI

Me kompetencë dhe siguri të arsyeshme mund të konstatojmë, nga pasqyrat financiare dhe shpalosjet e pasqyrave, shihet se ekziston një saktësi e mjaftueshme në regjistrime kontabël dhe evidenca. Nuk kemi arritur të vërejmë ndonjë gabim apo tendencë për ndonjë gabim material apo ndonjë mashtrim. Gjatë sigurimit të dokumentacionit nuk kemi hasur në ndonjë pengesë për ta bërë këtë. Auditimin e kemi planifikuar, dhe programin e auditimit e kemi realizuar sipas dinamikës së paraparë. Ne do të dëshironim të shprehim vlerësimin dhe falënderimin tonë për bashkëpunim dhe asistencë të ofruar nga personeli i kontaktuar i N.P.L. "Higjiena" Sh.A.

